

Home > Aktualitet > Vrasja e 55-vjeçarit në Dukagjin nga kushëriri, Policia zbardh motivin

AKTUALITET

Vrasja e 55-vjeçarit në Dukagjin nga kushëriri, Policia zbardh motivin

Policia njofton se Marrash Arraj 26 vjeç vrau kushëririn e tij pasi dy familjet kanë pasur konflikte të mëparshme.



Lazër Arraj.

22 Tetor, 2019 14:47

Shkodër- Për vrasjen e 55-vjeçarit Lazër Arraj që ndodhi në fshatin Shosh të Dukagjinit mesditën e djeshme, Policia njofton se Marrash Arraj 26 vjeç vrau kushëririn e tij pasi dy familjet kanë pasur konflikte të mëparshme.

Njoftimi i Policisë:

Zbardhet dhe dokumentohet ngjarja e ndodhur dje, ku mbeti i vrarë me armë zjarri shtetasi L. A.

Arrestohet autori i dyshuar i kësaj ngjarjeje.

Nga strukturat e D. V. P. Shkodër nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, falë një pune intensive hetimore dhe në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative është bërë dokumentimi ligjor dhe arrestimi në flagrancë i autorit të dyshuar, shtetasit:

M. A., 26 vjeç, banues në fshatin Shtoj i Ri, Shkodër.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](https://dosja.al)

Arrestimi i tij u bë pasi dje më datë 21.10.2019 dyshohet se ka vrarë me armë zjarri shtetasin L. A., në fshatin Palaj, Njësia Administrative Shosh, Shkodër.

Kjo ngjarje dyshohet të ketë ndodhur për konflikte të mëparshme mes familjeve.

Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Armëmbajtja pa leje”.

Policia ka arrestuar të dyshuarin kryesor për vrasjen e 55-vjeçarit Lazër Arraj në fshatin Shosh të Dukagjinit. Që prej ditës së djeshme, kur edhe ndodhi ngjarja uniformat blu kishin “blinduar” zonën dhe kishin nisur me krehjen e saj për kapjen e të dyshuarit. **26-vjeçari, djali i xhaxhait**, u arrestua mëngjesin e sotëm.

J.V/Dosja.al

DR. LIGHT

ETIKETA: #lazer arraj #Marash Arraj #vrasja ne shosh te shkodres

24

SHARES



Previous article

“Më e mirë e ëma se të bijat”/ Albërie Hadërgjonaj poston foto me vajzat nga shtrati

Next article

Zgjedhjet në Kanada/ Trudeau rrëmben fitoren për të formuar qeverinë e pakicave

Shto Koment

Emri Juaj*

E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME